



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
PA1: 08-57
03.03.2026**

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 54, paragrafi (4) dhe nenit 104, paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-57 datë 16.2.2026 dhe Propozimin PA1 nr.08-57 datë 2.3.2026, në pajtim me Konkluzionin, nr.ark.02-774/4 datë 2.3.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 9-të mbajtur më 2.3.2026, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim televiziv

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (ShTR) Prva Skopska Televizija ShPKNjP Shkup (me emër të mëparshëm si Shoqëri Tregtare Radiodifuzive (ShTR) TV MTM ShPKNjP Shkup), PA1 nr.08-16 datë 7.9.2023.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (AShMA) në seancën e 7-të mbajtur më 18.2.2026, me Konkluzionin nr.ark.02-624/3 datë 18.2.2026, miratoi propozimin e dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë, PA1 nr.08-57 datë 16.2.2026 dhe inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Prva Skopska Televizija ShPKNjP Shkup (me emër të mëparshëm ShTR TV MTM ShPKNjP Shkup), PA1 nr.08-16 datë 7.9.2023, për shkak se pas mbikëqyrjes së kryer të rregullt administrative, në Raportin me shkrim me nr.ark.05-634/1 datë 16.2.2026, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga ASHMA, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të nenit 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV), përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv ASHMA-së.

Në lidhje me këtë, nga ana e ASHMA-së më 19.2.2026, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA1 nr.08-57 datë 19.2.2026, për njoftim se nëse nuk paguan plotësisht kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë)

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).



**Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги**

**ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија**

Тел. + 389 2 3103 400

**www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk**





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

ditësh nga dita e Propozimit të pranuar për inicim të procedurës për heqjen e lejes për transmetim televiziv, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv. Njoftimi PA1 nr.08-57 datë 19.2.2025, është dërguar me shkrim me postë rekomanduese drejtuar ShTR Prva Skopska Televizija ShPKNJ P Shkup (me emër të mëparshëm ShTR TV MTM ShPKNJ P Shkup) dhe është pranuar nga transmetuesi më 19.2.2026. Njëkohësisht, Njoftimi më 19.2.2026, është dërguar dhe në formë elektronike në e-mail adresën zyrtare të transmetuesit regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV dhe në regjistrin e radiodifuzerëve që udhëhiqet nga Agjencia.

Megjithatë, më 2.3.2026 nga Sektori për financa dhe logjistikë, drejtorit të Agjencisë i është dorëzuar Njoftim nr.ark.05-634/2 datë 2.3.2026 se ShTR Prva Skopska Televizija ShPKNJ P Shkup (me emër të mëparshëm ShTR TV MTM ShPKNJ P Shkup), më 2.3.2026, ka kryer pagesën në shumë prej 1.334.165,00 (një milion e treqind e tridhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) denarë, me të cilën transmetuesi ka paguar plotësisht kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe nenit 20, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 10 të LShMAAV, në pajtim me nenin 54, paragrafi (4) dhe nenit 104, paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-57 datë 16.2.2026 dhe Propozimin PA1 nr.08-57 datë 2.3.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-774/4 datë 2.3.2026, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 9-të mbajtur më 2.3.2026, vendoj ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa mësipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani